



GJETJE NGA RAPORTI I VLERËSIMIT

MBI PRAKTIKAT E MEKANIZMIT TË BUXHETIMIT ME
PJESËMARRJE DHE KONSULTIMIT NË NIVEL VENDOR

NË BASHKINË VLORE

SHTATOR 2019



GJETJE NGA RAPORTI I VLERËSIMIT

MBI PRAKTIKAT E MEKANIZMIT TË BUXHETIMIT ME PJESËMARRJE DHE KONSULTIMIT NË NIVEL VENDOR

NË BASHKINË VLORE

SHTATOR 2019



GJETJET NGA BASHKIA VLORE

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Riorganizimi i Bashkisë Vlorë si rezultat i Reformës Administrativo-Territoriale solli ndryshime të ndjeshme si në popullsi ashtu edhe në territore. Bashkia Vlorë tashmë përbëhet nga 5 njësi administrative (Vlorë, Orikum, Qendër Vlorë, Novoselë dhe Shushicë), 2 qytete (Vlorë dhe Orikum) dhe 37 fshatra. Territorët e Bashkisë u zmadhuan me 23 herë (nga 27 km² në 616.85 km²). dhe popullsia u rrit me gati 52% (104.827 banorë Census 2011 kundrejt 201,951 banorë regjistri i Gjendjes Civile 2019). Bashkia Vlorë renditet e gjashta në rang kombëtar për sa i përket numrit të popullsisë.

GJETJET STAFI I BASHKISË

Për përgatitjen e këtij raporti u pyetën 10 punonjës të Bashkisë Vlorë, të cilët përfshijnë: staf drejtues dhe specialistë të Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit, Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun, Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve, Shëndetit Publik dhe Mbrojtjes Konsumatore, Zyrës së Prokurimeve Publike, Koordinatorën për të Drejtën e Informimit dhe Koordinatorën për Njoftimin e Konsultimin Publik. Të gjithë të intervistuar përfaqësojnë drejtoritë që janë të përfshira në procesin e BP.

- Sipas burimeve zyrtare buxhetimi me pjesëmarrje në Bashkinë Vlorë ka filluar që prej vitit 2011 dhe paralelisht për disa vite është zhvilluar edhe buxhetimi gjinor. Të gjithë të intervistuarit kanë pohuar se bashkia ka përdorur ndër vite mekanizma dhe procese të pjesëmarrjes dhe konsultimit me qytetarët, përfshirë edhe BP. Ndër mekanizmat që ata përmendin si më efektive janë dëgjesat publike dhe takimet e hapura konsultuese me qytetarë, grupe interesi dhe komunitetin e biznesit, si dhe platforma online për mbledhjen e prioriteteve të qytetarëve në funksion të BP. Proceset e përmendura kanë patur të bëjnë me përgatitjen dhe konsultimin e buxhetit vjetor dhe afatmesëm, taksat dhe tarifat vendore, Planin e Përgjithshëm Vendor, Planin e Veprimit për Rininë, ndërtimin e Landfill-it dhe vepra të tjera madhore.
- Të pyetur se kush e ka nisur së pari procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje në Bashkinë Vlorë të intervistuarit sqarojnë se fillimisht është iniciuar nga organizata lokale (80%) dhe donatorë (50%), por dhe bashkia ka caktuar fonde të veçanta për realizimin e procesit duke kontraktuar dhe bashkëpunuar me një prej organizatave aktive lokale.
- Sipas punonjësve të bashkisë, institucioni ka procedurë në lidhje me procesin dhe zbatimin e BP, e cila sipas tyre është një urdhër i brendshëm i Kryetarit të Bashkisë,

shoqëruar me kalendarin e dëgjësive publike. Por ky urdhër nuk e shteron gjithë procesin e buxhetimit me pjesëmarrje, i cili në vetvete kërkon një rregullore apo udhëzim të detajuar që do të orientonte punën e personave apo grupeve përgjegjëse për zbatimin e tij në të gjitha fazat.

- Vetë procesi organizohet sipas disa hapave, ndër të cilat të intervistuarit listojnë përgatitjen e kalendarit të takimeve për mbledhjen e prioriteteve, përgatitjen dhe shpërndarjen e njoftimeve për dëgjesat publike në mediat sociale dhe ato lokale. Ndërkohë bëhen njoftime me email apo gojarisht nga administratorët e lagjeve dhe sekretari i KB në qytet dhe administratorët e kryepleqtë në NJA. Gjatë dëgjësive mblidhen prioritetet e komunitetit, të cilat më vonë shqyrtohen duke pasqyruar në buxhet ato që shihen më të arsyeshme. Dafti final i buxhetit prezantohet për qytetarët në një takim të madh publik. Faza finale është miratimi i këto buxheti në KB.
- Si strukturat përgjegjëse për organizimin e procesit të BP-së nga të intervistuarit janë përmendur: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), i cili mbledh, analizon, shqyrton dhe ia përcjell kërkesat KB; Koordinatorin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik; Zyra e Informacionit dhe Kabineti i Kryetarit të Bashkisë (Drejtori i Kabinetit dhe këshilltarët e tij). Të intervistuarit shprehen që në këtë proces përfshihen të gjitha drejtoritë dhe më specifikisht ato që kanë kërkesa në varësi të tematikave, ndër të cilat: Drejtoria e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve, Sektori i Shërbimeve, Urbanistika, Sektori i Zhvillimit të Komuniteteve dhe sektorë të tjerë vartës.
- Të pyetur për format e njoftimit dhe përfshirjes qytetare, 90% të intervistuarve raportuan se lajmërimet përmes mediave sociale, mediave lokale dhe ato individuale ishin mënyrat më të praktikuara nga bashkia (sipas tyre përdoren gjithmonë ose shpesh). Ata dhanë mendime të ndryshme në lidhje me afishimin e lajmërimeve në ambientet e bashkisë (40% u shprehen gjithmonë dhe 40% ndonjëherë). Vërehet që regjistri elektronik, posta elektronike dhe botimet në gazetatat lokale thuajse nuk përdoren fare si forma njoftimi për këtë proces.
- Sipas të intervistuarve ka një sërë mjeteve që përdoren për të siguruar pjesëmarrjen e grupeve të synuara, por sipas tyre ka mungesë të lartë interesi dhe angazhimi nga ana e qytetarëve. Nga ana e tyre pretendohet se lajmërimet bëhen nga gjithë strukturat e përfshira në proces për ta shpërndarë sa më mirë informacionin. Kur pyeten nëse ka gjëra që duhet të rregullohen apo bëhen më mirë të intervistuarit bien dakord që procesi ka nevojë për përmirësim. Ata sugjerojnë që duhet të hartohet një rregullore apo udhëzues i plotë i detajur me të gjitha hapat për realizimin e procesit, që do ta formalizonte atë. Kjo do të rriste kapacitetet dhe përgjegjësinë e personave të ngarkuar për zbatimin e tij (përfshirë edhe Këshillin Bashkiak).
- 70% e të intervistuarve shprehen se ka një regjistër për dëgjesat publike, i cili përditësohet sistematikisht dhe mbahet në arkivin e bashkisë. Lidhur me përgjegjësitë e

mbajtjes dhe përditësimit të tij ata u shprehën se është detyrë e Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik. Të intervistuarit që nuk ishin në dijeni të ekzistencës së regjistrimit elektronik mendonin se përgjegjës për përditësimin e tij janë Përgjegjësi i Buxhetit dhe Sekretari i Këshillit Bashkiak. Të pyetur më tej nëse ky regjistër është i publikuar online, 70% konfirmuan që jo dhe pjesa tjetër që nuk kishin dijeni. Ndërkohë që ata shprehen se procesverbali i takimeve me publikun mbahet në çdo rast, por nuk publikohet asnjëherë.

- Gjithë të intervistuarit konfirmojnë mungesë statistikash apo të dhënash të detajuara në lidhje me numrin dhe përkatësinë e pjesëmarrësve në dëgjesat publike. Kjo ndodh pasi gjatë konsultimeve nuk shpërndahen lista pjesëmarrësish që do të evidentonin numrin e qytetarëve që marrin pjesë në to dhe specifika të tyre sipas gjinisë, moshës, grupeve të interesit, etj. Pas çdo takimi publikohen në faqen e bashkisë online foto ose video nga takimi, por nuk ka asnjë formë të mirëfilltë monitorimi të këtij treguesi të rëndësishëm të procesit të buxhetimit me pjesëmarrje.
- Mungesa e monitorimit të procesit vërehet në të gjitha hallkat e tij. 70% e tyre shprehen se nuk ka asnjë formë apo mekanizëm monitorimi apo vlerësimi të BP-së. Nga përgjigjet e disa prej të intervistuarve del që ka një lloj ndjekshmërie të procesit, e cila sipas intervistave realizohet nga Këshilltari Ekonomik, por nuk është e dokumentuar.
- Procesi i zbatimit të BP-së sipas të intervistuarve kalon nëpër shumë vështirësi e sfida që lidhen kryesisht me mungesën e infrastrukturës së duhur dhe fondeve të mjaftueshme, e shoqëruar me kapacitete dhe eksperiencë të pamjaftueshme nga ana e stafit të bashkisë. Ata shprehen se ka indiferencë, informacion, ndërgjegjësim dhe pjesëmarrje të ulët qytetare nëpër takime, ndërkohë që bashkia ka vështirësi në përfshirjen e grupeve të ndryshme të interesit. Megjithatë ata mendojnë se aktivizimi qytetar ka shënuar rritje, kjo edhe për shkak të rritjes së ndërgjegjësimit dhe informimit përmes formave të reja të zbatuara, siç është mbledhja e prioriteteve nëpërmjet një anketimi online.
- Për të përmirësuar zbatimin e procesit BP nevojat kryesore të evidentuara nga të intervistuarit janë përcaktimi dhe krijimi i procedurave të duhura (50%), rritja e burimeve financiare dhe materiale (50%), përmirësimi i burimeve njerëzore (40%) dhe rritje kapacitetesh përmes trajnimit e asistencës teknike (60%) dhe sigurimi i infrastrukturës së përshtatshme (40%).
- Rekomandimet për të përmirësuar zbatimin e këtij procesi lidhen kryesisht me asistencën teknike, rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, si edhe informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve, sidomos në lidhje me pagimin e taksave dhe tarifave vendore dhe përkthimin e tyre në investime konkrete në komunitet.

GJETJET KËSHILLI BASHKIAK

Pas zgjedhjeve vendore 2015, Këshilli Bashkiak Vlorë numëronte 41 këshilltarë vendorë, nga të cilët 19 gra (46.4%) dhe 22 burra (53.6%). Kjo deri në vitin 2019, pasi rritja e popullsisë me mbi 200,000 banorëve, e çoi numrin e këshilltarëve në 51. Këshilli i ri Bashkiak i dal si rezultat i zgjedhjeve lokale të mbajtura në 30 qershor 2019 ka në përbërjen e tij 24 gra (47%) dhe 27 burra (53%), kryesisht të forcës së majtë. Këshilli Bashkiak Vlorë ka një Aleancë të Grave Këshilltare.

Për përgatitjen e këtij raporti, u pyetën 20 anëtarë të ish-Këshillit Bashkiak Vlorë, por për t'i unifikuar edhe me bashkitë e tjera janë përdorur intervistat më cilësore të 10 këshilltarëve që janë marrë dhe kanë patur më tepër njohuri në lidhje me procesin BP, nga të cilët 5 këshilltarë përfaqësues të PS, 2 të PD, 1 të PDIU, 1 të PPBK dhe 1 të PSD.

- 100% e këshilltarëve të intervistuar të Bashkisë Vlorë e konsiderojnë shumë të rëndësishme pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimarrjen vendore. Të gjithë shprehen që është një detyrim ligjor që duhet përmbushur, pasi nxit dhe mundëson angazhimin qytetar në proceset planifikuese dhe monitoruese të menaxhimit të financave publike dhe vendore, si dhe rrit transparencën në administrimin vendor. Këshilltarët mendojnë se kjo është një mundësi shumë e mirë që qytetarët të ngrenë zërin për shqetësimet dhe nevojat e tyre, si dhe të reagojnë e mbrojnë cilësinë dhe jetëgjatësinë e investimeve në komunitetet ku jetojnë. E gjithë kjo qasje i sjell ata më pranë qeverisjes dhe vendimarrjes së përbashkët dhe e bënë punën e bashkisë më të besueshme në funksion të përmirësimit të jetës së komunitetit.
- Të gjithë të intervistuarit shprehen se kanë njohuri mbi kudin përkatës ligjor, por kur u kërkon të përmendin disa nga ligjet ose proceset që parashikojnë angazhimin e tyre dallojnë dy grupe këshilltarësh që ndryshojnë në qasjen e tyre. Ata që nuk kanë shumë njohuri mbi to (30%) përmendin vetëm Ligjin për Vetëqeverisjen Vendore dhe pjesa tjetër (70%) renditin të paktën 2 ose disa prej ligjeve. Nga kjo kategori e fundit vetëm 30% kanë njohuri më të thelluara.
- Shumica e të intervistuarve (60%) mendojnë që kuadri ligjor mbi pjesëmarrjen dhe konsultimin publik në nivel vendor është i qartë, por jo i plotë (vetëm 10% e vlerësojnë të qartë dhe të plotë). Sipas tyre legjislati ekziston, por ka nevojë për akte nënligjore përkatëse. Sugjerimet e tyre lidhen me Ligjin për Zhvillimin e Territorit, për të cilin këshilltarët mendojnë se ka ende për të bërë në mënyrën e zbatimit, pasi është e paqartë për ta. Për këtë ata sygjerojnë përgatitjen e një materiali të përgatitur paraprakisht, që do të shmangte shfletimin e detyrueshëm të legjislatit në çdo kohë për një proces kaq të thjeshtë e specifik. Këshilltarët mendojnë që një pjesë e buxhetit duhet të përdoret për nevojat specifike të procesit, siç është dhe një material procedural. Pjesa e mbetur e këshilltarëve të intervistuar (30%) mendojnë që baza ligjore është e paqartë dhe jo e plotë.

- Të pyetur për sugjerime apo rekomandime në lidhje me rishikimin apo plotësime të mundshme të legjislacionit përkatës, në radhë të parë këshilltarët e intervistuar pranojnë që pavarësisht se kuadri ligjor ekziston, kapacitetet dhe performanca e këshilltarëve në lidhje me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ligji është modeste. Shumica e tyre u shprehën që edhe pse legjislacioni aktual është i plotë, ai paraqet vështirësi në zbatim. Disa sygjëruan rishikim të Ligjit të Vetëqeverisjes Vendore apo ligjeve të veçanta. Plotësimi me akte nënligjore, rregullore dhe procedura të detajuara sipas tyre duhet të saktësojë përgjegjësitë ligjore dhe administrative në rast moszbatimi për personat apo grupet përgjegjëse të cilët duhet të sigurojnë pjesëmarrjen qytetare në proceset e konsultimit publik dhe jo vetëm.
- Të gjithë këshilltarët (100%) konfirmojnë se ka një rregullore të Këshillit Bashkiak, që në disa raste zbatohet dhe në disa raste jo, por në këtë rregullore nuk përfshihet procesi i buxhetimit me pjesëmarrje ose procese të konsultimit me qytetarët. Sipas tyre rregullorja aktuale e Këshillit Bashkiak Vlorë ka nevojë për përmirësime.
- Përsa i përket bashkëpunimit mes këshillit bashkiak dhe bashkisë 70% e këshilltarëve të intervistuar mendojnë që ka. Ata shprehen se vetëm në periudhën e fundvitit kur fillon puna për hartimin e buxhetit të vitit pasardhës ndërtohet nga ana e administratës një grafik i bashkëpunimit të marrjes së mendimeve për hartimin e buxhetit nëpërmjet takimeve me komunitetin. Informimi i këshilltarëve bëhet një ditë para dëgjësës përmes kalendarit të dëgjësave publike, në të cilin nuk jepen data të sakta, por periudhat dhe vendet ku janë parashikuar të zhvillohen dëgjësat. Këshilltarët përcjellin në takimet e komisioneve ku bëjnë pjesë prioritetet e qytetarëve që kanë mbledhur nga dëgjësat publike, ku për ato më të rëndësishmet merret një miratim në parim për t'u vendosur në projekt-buxhet. Nga eksperiencia, shumë pak nga prioritetet që kanë sjellë këshilltarët janë vendosur në buxhet ose dhe në rastet kur janë vendosur nuk kanë gjetur zbatim, dhe për këtë arsye këshilltarët shpesh ndjehen të përdorur.
- Kur këshilltarët pyeten për infrastrukturën e realizimit dhe ndjekjen e buxhetimit me pjesëmarrje të gjithë shprehen njëzëri se është e pamjaftueshme. Ndërkohë që ligji e detyron këshillin që për vendimarrje të rëndësishme të bëjë konsultim me qytetarët, kjo nuk shoqërohet me vlera financiare. Sipas të intervistuarve KB duhet të ketë buxhetin e tij të pavaruar për zhvillimin e takimeve publike me qytetarët si në qytet, ashtu edhe në NJA-të. Ky buxhet duhet të parashikojë shpenzime për kancelari, pajisje kompjuterike dhe minimumi për transport për në zonat rurale, i cili aktualisht mbulohet nga vetë këshilltarët.
- Të pyetur për mjetet që përdor bashkia për njoftimin e procesit të BP, të intervistuarit zgjedhën si format më të përdorshme mediat lokale (90%) dhe faqen e Facebook-ut të bashkisë (80%). Të tjerat vijnë me lajmërimet publik të afishuar në ambjentet e Bashkisë (60%) dhe lajmërimet përmes email (50%). Nga përgjigjet e të intervistuarve vërehet se lajmërimi përmes apo vetë regjistri elektronik nuk ekziston në Bashkinë Vlorë, ose këshilltarët nuk janë në dijeni të tij. Gjithashtu, të intervistuarit nuk e renditin

lajmërimin përmes gazetave lokale si një nga mjetet e përdorura për njoftimin e procesit BP.

- Të gjithë këshilltarët e intervistuar shprehen se nuk ka një mekanizëm monitorimi dhe raportimi të procesit BP, por sygjerojnë që një instrument i tillë duhet parashikuar si shtesë në rregulloren e KB. Sipas tyre, këshilltarët nuk kanë asnjë lloj aksesit për të monitoruar ose kërkuar llogari në mbledhjet e këshillit mbi proceset e konsultimit me publikun që kanë ndodhur më parë. Kjo pasi bashkia propozon ndryshime të buxhetit të paktën 2-3 herë në vit, duke e bërë të pamundur monitorimin e zbatueshmërisë të proceseve të nisura, të lëna në mes apo të përfunduara. I vetmi proces monitorues që këshilltarët mund të jenë pjesë është paraqitja një vit më pas e buxhetit faktik. Pavarësisht se aty konstatojnë që një pjesë e mirë e projekteve kanë mbetur në mes ose nuk kanë përfunduar, ata nuk kanë asnjë mundësi që të kërkojnë arsyt ose të detyrojnë bashkinë të raportojë përse ka ndodhur kjo.
- 80% e këshilltarëve të intervistuar janë përgjigjur që nuk ka një format raportimi formal në këshill mbi procesin BP dhe rekomandimet që dalin prej tij. Ata shprehen se raportimi bëhet vetëm kur draft buxheti paraqitet në këshill (këshilltarët njoftohen vetëm 2-3 ditë përpara), ku nuk ka patur asnjë diskutim të përbashkët paraprak për përfshirjen e prioritetëve të identifikuar më parë nga këshilltarët. Edhe pse këshilltarët kanë luftuar me grupe të caktuara ose në mënyrë të pavarur për përfshirjen e projekteve të veçanta në buxhet, ata janë njohur me formën finale të draft-buxhetit vetëm në dëgjuesën publike që bashkia realizon një ditë para mbledhjes së KB për miratimin e projekteve të veçanta për të cilat kanë lobuar. Në këtë mënyrë ata nuk kanë mundësi të ndryshojnë ose të verifikojnë sa nga kërkesat e tyre janë pasqyruar në buxhet, pasi në mbledhjen një ditë më vonë buxheti aprovohet si një i tërë dhe jo në pjesë të veçanta. Ndërsa 20% e këshilltarëve që konfirmuan që ka forma të raportimit u shprehën se prioritetet e qytetarëve përcillen në komisionet përkatëse të KB dhe në mbledhjen e këshillit tërhiqet vërejtje për këshilltarët që nuk marrin pjesë në dëgjuesat me qytetarët.
- Ndërkohë që shumica e këshilltarëve shprehen për mungesë të raportimit formal, paqartësi vërehet edhe për procesin e miratimit të projekt-akteve apo vendimeve që lidhen me BP. 20% e tyre thonë që ato miratohen të përfshira në projekt-buxhetin e propozuar nga Bashkia, 20% si pikë e veçantë në mbledhjen e KB dhe 60% e tyre nuk kanë dijeni. Të gjithë të intervistuarit konfirmojnë që nuk ka asnjë rast të kthimit nga Këshilli të projekt-vendimeve për BP. Sipas tyre këshilltarët zakonisht marrin vendime apo miratojnë politikisht në bllok dhe janë vetëm përfaqësuesit e partive opozitare që votojnë kundër.
- Gjithashtu, të gjithë këshilltarët shprehen se nuk ka ndjekje të zbatimit të vendimeve të BP nga ana e këshillit bashkiak, ndërsa ndjekin individualisht zbatimin e çështjeve të veçanta. Këshilltarët shprehen se duhet të ketë ndryshime ligjore, pasi vendimi i nxjerrë nga këshilli është akt normativ dhe moszbatimi i tij duhet të ketë përgjegjësi administrative. Duhet të bëhet një analizë e performancës e cila ekziston në ligj, por nuk

është detyruese. Sipas tyre, analiza duhet të jetë detyruese dhe me afate, sepse duke bërë analizën, del edhe si janë përdorur fondet.

- Nga vrojtimi rezulton se të gjithë këshilltarët e intervistuar kanë dijeni për mekanizmat që sigurojnë pjesëmarrjen dhe konsultimin me qytetarët që KB duhet të përdor, por nga përgjigjet vërehet se vetëm shumë pak prej tyre gjejnë zbatim nga këshilltarët. Bazuar në vlerësimet e dhëna ndjehet që puna e tyre në ndërvëprimin me qytetarët përmes gjithë mekanizmave që parashikon ligji është e pamjaftueshme. 90% e tyre u shprehën se vetëm ndonjëherë marrin pjesë në takimet në lagje, fshatra dhe njësi administrative dhe po kaq përdornin edhe mediat sociale, platformat online ose telefonatat. Është shqetësuese që 70% e tyre e cilësonin buxhetimin me pjesëmarrje si një nga mekanizmat që e përdornin shumë rrallë dhe po ashtu kaq rrallë e konsultonin edhe faqen e bashkisë. 70% raportonin se seancat dëgjimore publike të KB apo të organizuara nga ata vetë nuk kryheshin asnjëherë, ndërkohë që studimet mbi matjen e kënaqësisë së qytetarëve dhe konsultimet me ekspertë duken si mekanizma që nuk njihen fare.
- Të pyetur në lidhje me aktet dhe dokumentat e miratuara dy vitet e fundit për të cilat janë kryer konsultime me publikun, këshilltarët njëzëri konfirmojnë ato për buxhetin vjetor (100%), pasuar nga tarifatat dhe taksat vendore (80%). Më pak se gjysma e tyre (40%) raportojnë konsultimet e kryera për projektet e investimeve dhe planet strategjike dhe këtu specifikojnë konsultimet për Planin e Përgjithshëm Vendor.
- Këshilltarët shprehen se nuk ka një mekanizëm për matjen e kënaqësisë së qytetarëve, por komentet nga qytetarët i marrin kryesisht në takime joformale me ta. 70% e tyre thonë që matja e kënaqësisë nuk bëhet asnjëherë, kundrejt 30% që shprehen që kjo ndodh rrallë. Të gjithë këshilltarët konfirmojnë marrjen e ankesave nga qytetarë apo grupe interesi (rreth 6-8 të dokumentuara), por ato që vijnë jo joformalisht janë shumë më tepër. Ka këshilltarë që janë më pak të përfshirë me çështjen e ankesave, ka edhe të tjerë që pothuajse në çdo mbledhje ngrenë nga një ankesë.
- Këshilltarët e intervistuar kanë këndvështrime të ndryshme për mënyrën se si procedohet me këto ankesa. Disa shprehen se pavarësisht se i trajtojnë ankesat e marra në KB, ato nuk merren në konsideratë apo nuk iu kthehet përgjigje. Të intervistuarit përmendin rastin e kërkesave për ulje apo reduktim të taksave dhe tarifave, ku propozimet janë hedhur poshtë me forcën e kartonave nga këshilltarët e të njëjtës forcë politike me atë të Kryetarit të Bashkisë. Po ashtu, rekomandime të ardhura në lidhje me projekte të ndryshme për investime nuk janë marrë në konsideratë me pretendimin që nuk bën pjesë në prioritetet e bashkisë. Këshilltarët e tjerë thonë që ankesat diskutohen në KB dhe adresohen në drejtoritë përkatëse të bashkisë, në mënyrë që të gjendet zgjidhje dhe në vitin pasardhës të mos përsëritet e njëjta situatë.
- Nga përgjigjet e këshilltarëve vihet re se jo gjithmonë qytetarët njoftohen në lidhje me ankesat e tyre. Në dijeninë e tyre mënyrat sesi qytetarët njoftohen janë përmes

komunikimit të drejtpërdrejtë, telefonatave dhe takimeve me ta. Në mjaft raste këshilltarët ndërhyjnë për të lehtësuar komunikimin mes drejtorive përkatëse dhe qytetarëve. Sipas tyre qytetarët mjaftohen me informacionin që mund të marrin nga zhvillimi i seancës së mbledhjes së këshillit, kur ato transmetohen në mediat lokale.

- 100% e këshilltarëve të intervistuar raportojnë se KB nuk ka ndonjë sistem monitorimi dhe vlerësimi të mekanizmave të përdorur, që do të thotë që nuk ka indikatorët që maten apo persona përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin. Gjithashtu, të gjithë shprehen se nuk kanë aprovuar asnjë raport për transparencën e proceseve vendimarrëse. I vetmi raport i aprovuar gjatë vitit 2018 është Programi i Transparencës, ku pjesë integrale e tij është edhe informimi i qytetarëve.
- Të intervistuarit mendojnë se kapacitetet e këshillit bashkiak për proceset e konsultimit janë jo të kënaqshme, ku 70% e tyre i vlerësojnë këshilltarët në përgjithësi të aftë /pak të aftë dhe 30% të tyre jo të aftë për realizimin e kësaj përgjegjësie të rëndësishme që ata duhet të ushtrojnë.
- Të gjithë këshilltarët mendojnë që RAT ka patur ndikim të fortë në zbatimin e mekanizmave për angazhimin qytetar dhe konsultimin publik. Shumica e tyre e konsiderojnë atë me ndikime negative dhe disavantazhuese për NJA-të, e sidomos zonat largëta rurale, të cilat nuk janë shkelur kurrë për të parë situatën. Ata shprehen se Reforma ka harruar qytetarin e NJA-ve, të cilat janë më pak të përfaqësuar me këtë reformë. Sipas tyre konsultimi publik realizohet formalisht vetëm si detyrim ligjor dhe kryesisht në zonat më të mëdha urbane. Dikush nga të intervistuarit mendon se Reforma i ka dhënë më shumë kompetenca Kryetarit të Bashkisë duke hequr mekanizmin e kontrollit të Këshillit mbi administratën. Në këndvështrimin e tyre struktura e bashkisë, fondi dhe niveli i pagave duhet të miratohen nga KB, ndërkohë që këshilli tani miraton vetëm numrin e punonjësve dhe fondin pa ditur rolin e secilit punonjës.
- Këshilltarët hasin një sërë vështirësish në lidhje me angazhimin dhe konsultimin me publikun, që kanë lidhje kryesisht me financat, logjistikën, kapacitetet dhe informacionin. Ata komentojnë se mundësitë e pakta financiare dhe në logjistikë krijojnë mjaft vështirësi në punën e tyre. Kushtet dhe infrastruktura e munguar për të realizuar proceset me pjesëmarrje lënë për të dëshiruar. Salla e Këshillit Bashkiak është provizore dhe takimet e komisioneve bëhen në salla të bashkisë. Kontaktet me qytetarët janë rastësore ose kur kontaktohen direkt prej tyre, pasi mungon ka një vend ku të kryhen takimet. Siç u theksua më sipër mungojnë mjete të domosdoshme për ushtrimin e funksionit të tyre si këshilltarë, të tilla si kancelari e kompjutera, pa harruar financat për mbulime shpenzimesh për transportin në zonat rurale apo trajnim e rritje kapacitetesh të këshilltarëve. Ata shprehen për kapacitete jo fort të kënaqshme të këshilltarëve në përgjithësi, njohje të pakët të legjislacionit të pushtetit vendor dhe rolit të tyre në qeverisjen vendore. Shumë herë diskutimet rutinë politizohen në dëm të këshilltarit për përgjegjësi, të cilat nuk i ka. Sfidë për këshilltarët gjithashtu mbetet përmirësimi i transparencës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së organeve të qeverisjes lokale.

Disa prej tyre mendojnë se burimet e pakta publike shpenzohen shpesh në mënyrë të gabuar ose për grupe përfituesish të gabuar, pa marr parasysh nevojat dhe kërkesat e qytetarëve.

- Të pyetur për nevojat që KB ka për përmirësimin e proceseve të konsultimit, theksohet nevoja e mirëstrukturimit të këtij procesi, përmes përmirësimit të procedurave, buxheteve e infrastrukturës së duhur dhe rritjes së informimit dhe transparencës. Ndër rekomandimet e rëndësishme që ata renditin janë:
 - Rishikim ose amendim të Ligjit të Vetëqeverisjes Vendore ose ligjeve të veçanta që detyrojnë administratën vendore të informojë, mobilzojë dhe sigurojë pjesëmarrje qytetare në procesin BP dhe jo vetëm (mbajtje përgjegjësie ligjore dhe administrative).
 - Përmirësim të Rregullores së Këshillit Bashkiak duke përfshirë edhe procesin e Buxhetimit me Pjesëmarrje në të.
 - Krijim i një buxheti të veçantë e të pavaruar për Këshillin Bashkiak për t'u përdorur për kancelari, pajisje kompjuterike, transport, trajnim, binjakëzim e marrje eksperiancash, thithjen e aftësisë profesionale dhe ekspertëve të fushës, zhvillimin e debateve publike me qytetarët në qytet dhe NJA-të, etj. Të rishikohet gjithashtu shpërblimi i këshilltarëve duke vlerësuar punën e tyre nëpër komisione.
 - Rritje kapacitetesh përmes trajnimeve, shkëmbimit të praktikave dhe eksperincave pozitive.
 - Përmirësim i targetimit të buxhetit realizuar nga kërkesat e qytetarëve, grupeve të interesit dhe aktorëve lokalë dhe jo nga këndvështrimi apo projektet e administratës apo vetë drejtuesit lokal.
 - Rritje të transparencës dhe koordinimit nga ana e bashkisë për planifikim me anëtarët e Këshillit Bashkiak në lidhje me gjithë procesin e BP.
 - Krijimi i sallave të veçanta apo qendrave të informimit për zhvillimin e takimeve me qytetarët në ambiente neutrale në njësitë administrative.
 - Nxjerrja e një gazete lokale javore ose mujore për informimin periodik të qytetarëve. Informimi nëpërmjet televizionit ndodh, por jo të gjithë qytetarët e ndjekin, ndërsa informimi përmes një broshure është më i prekshëm për ta.



**Përmirësimi i Procesit të
Buxhetimit të Konsultuar
dhe me Pjesëmarrje**

**Improvement of Consulted and
Participatory Budgeting Process**